

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumn-it në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë dhe me nismën e studentëve të kësaj dege organizuan një aktivitet sensibilizues në kuadër të "Ditës Botërore të Luftës Kundër HIV/AIDS".

Ky aktivitet pati si qëllim të rrisë ndërgjegjësimin për parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e HIV/AIDS, duke ofruar informacion edukues dhe këshillim për të rinjtë. Aktiviteti synoi të theksojë rëndësinë e kujdesit shëndetësor, të promovojë mënyrat e mbrojtjes nga infeksioni dhe të eliminojë stigmën dhe paragjykimet ndaj personave që jetojnë me HIV/AIDS.

Në kuadër të këtij aktiviteti, u organizuan biseda informuese, shpërndarje materialesh edukative dhe mundësi për konsultime me profesionistë të kësaj fushe.



